

Hapet thirrja për aplikime për bursa për studentët dhe stafin e Universitetit të Tiranës, në kuadër të Programit Erasmus +, në Universitetin Valladolid, Spanjë

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët dhe stafin me kohë të plotë, për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020, në Universitetin Valladolid, Spanjë.

Llojet e mobilitetit /kohëzgjatja:

- Shkëmbimin e studentëve (1 semestër);
- Shkëmbimin e stafit (5 + 2 ditë);

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (850 Euro në muaj);
- Kompensimi ditor për stafin (160 Euro/ditë);
- Kostot e udhëtimit mbulohen nga Universiteti Valladolid (1 biletë vajtje-ardhje me destinacion universitet dërgues – universitet pritës)

Afati për aplikim: 30 Prill 2019.

I gjithë procesi i aplikimit kryhet online.

Për dokumentat e aplikimit lutemi ti referoheni guidës së aplikantit në këtë link:

https://www5.uva.es/uvamobplus/files/48367/Sellado_CONVOCATORIA_INCOMING_48367.pdf

Për të aplikuar klikoni në këtë link:

<https://www5.uva.es/uvamobplus/publico/inicio>

Për t'u njohur me fushat e studimit referohuni linkut:

<https://www5.uva.es/uvamobplus/publico/courses>

Për më shumë informacion mbi mënyrën e aplikimit klikoni linkun:

https://www5.uva.es/uvamobplus/files/How_to_apply_EN.pdf

Learning Agreement sipas modelit të Universitetit të Valladolid, i cili ndodhet në brendësi të aplikimit, duhet të firmoset në fillim nga Koordinatorin në nivel fakulteti dhe më pas nga Koordinatorin Institucional Erasmus+ Z. Skendaj.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al.

I gjithë procesi i aplikimit kryhet online.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!